

## MARRËVESHJE TË TRANSFERIMIT TË AKSIONEVE

Sot më datë 05/01/2023, hartohet marrëveshja e transferimit të aksioneve (më tej **Marrëveshja**) midis palëve kontraktuese :

**SHITËSI:** **Z.Luan Muça**, shtetas shqiptar, i lindur në Elbasan, i datëlindjes 05/08/1971, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike, mbajtës i letërnjoftimit ID me nr.034346965 dhe nr.personal H10805062A, *që më poshtë, në marrëveshje do të quhet Pala Shitëse*

**BLERËSI:** **Z.Bujar Muça**, shtetas shqiptar, i lindur në Elbasan, i datëlindjes 02/12/1972, banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pashaportës me nr.BG5876647 dhe nr.personal H21202129E, *që më poshtë në marrëveshje do të quhet Pala Blerëse*

të cilët ranë dakord për redaktimin e kësaj marrëveshje transferimi si më poshtë vijon:

### NENI 1 – OBJEKTI


1.1. Objekt i kësaj marrëveshje është shitja nga aksioneri i vetëm, **Z.Luan Muça**, i **26,937 aksioneve**, me vlerë nominale 10,000 (dhjetë mijë) lekë secili, që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të zotëruar në shoqërinë 55 INVEST sh.a, të cilat, i kalojnë në pronësi Palës Blerëse **Z.Bujar Muça**.

1.2. Kapitali themeltar i shoqërisë **55 INVEST Sh.a** është 269,370,000 (Dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë milion e treqind e shtatëdhjetë mijë) lekë dhe përbëhet nga 26,937 aksione me vlerë nominale 10,000 (dhjetë mijë) lekë secili .

### NENI 2 – ÇMIMI

2.1. Çmimi me të cilin do të shiten aksionet(100%) është 269,370,000 (Dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë milion e treqind e shtatëdhjetë mijë) lekë.

2.2. Kjo shumë do të shlyhet nga blerësi me marrëveshje midis palëve.



### NENI 3 – KUSHTET E SHITJES

3.1. Aksionet e shitura nga Pala Shitëse **Z.Luan Muça**, të aksioneve të zotëruara në shoqërinë **55 INVEST** sha, dhe cdo e drejtë dhe detyrim i cili buron prej aksioneve, i kalojnë në pronësi **Palës Blerëse**, menjëherë me nënshkrimin e kësaj marrëveshje nga Palët. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje nga palët, ortakut aktual i shoqërisë **55 INVEST** sha, përkatësisht **Shitësi Z.Luan Muça**, humbet pronësinë dhe nuk do të jetë më zotërues/pronar i aksioneve të shitura tek pala **Blerëse** dhe nuk ka dhe s' do të ketë asnjë pretendim lidhur me këtë.

3.2 Pala Blerëse fiton pronësinë e aksioneve me të gjitha të drejtat dhe detyrimet ligjore të cilat kanë lindur përpara momentit të shitjes së këtyre aksioneve dhe do të lindin në vazhdim si pasojë e zotërimit të këtyre aksioneve, përfshirë cdo të drejtë/detyrim i/e cila nuk është përmendur shprehimisht në këtë kontratë dhe në mënyrë ligjore ose/dhe kontraktuale i takon palës Blerëse.

### NENI 4 – TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËS BLERËSE.

4.1. Pala blerëse ka pranuar blerjen e paketës prej 100 % të aksioneve të **Z.Luan Muça**, të zotëruara në shoqërinë **55 INVEST** sh.a.

4.2. Pala blerëse fiton të drejtën e pronësisë mbi aksionet e blera prej saj, në momentin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje për shitjen e aksioneve.

### NENI 5 – TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËS SHITËSE.

5.1. Pala shitëse garanton palën blerëse për pronësinë e plotë dhe të ligjshme mbi paketën e aksioneve, objekt i kësaj marrëveshje.

5.2. Pala shitëse garanton të drejtat ligjore të blerësve në lidhje me pronësinë mbi objektin e kësaj marrëveshje.

### NENI 6 – TË NDRYSHME.

6.2. Kjo marrëveshje iu lexua gojarisht palëve. Kjo marrëveshje me kërkesën e palëve përpilohet në gjuhën shqipe në dy kopje. Nga këto, nga një kopje e marrin palët.

6.3. Palët pasi e kuptuan drejt përmbajtjen e kësaj marrëveshje, e gjetën atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë dhe e nënshkruan atë pa asnjë pretendim.

### PALËT KONTRAKTUESE

PALA BLERËSE  
Z.Bujar Muça

*Bujar Muça*  
*[Signature]*

PALA SHITËSE  
Aksioneri i vetëm  
Z.Luan Muça

*Luan Muça*  
*[Signature]*